

**DATAT HISTORIKE REFLEKTOJNË RRUGËTIMIN  
E POPULLIT TONË  
Darling Ismail VLORA**

Të nderuar organizatorë të Konferencës «102 vjet shtet shqiptar», të nderuar bashkatdhetarë, pjesëmarrës, miq e të ftuar. Fillimisht dëshiroj të falënderoj organizatorët për ftesën që më bënë për të qenë i pranishëm gjatë punimeve të kësaj Konference si shqiptar, por edhe si pasardhës i Ismail Qemal bej Vlorës, njeriut që më 28 nëntor 1912 shpalli Pavarësinë e Shqipërisë. Bashkë me falënderimin ju shpreh edhe keqardhjen për pamundësinë e të qenit mes jush, shkak i largësisë dhe impenjimeve familjare. Datat historike, përveç rëndësisë së tyre, në kohë na bëjnë të mblidhemi për të përkujtuar e reflektuar mbi rëndësinë që kanë pasur dhe ndikimin që ato kanë lënë në ecurinë e popullit tonë, në rrugën e gjatë drejt lirisë dhe konsolidimit të shtetit shqiptar. Midis këtyre datave padyshim spikat dita e 28 nëntorit 1912, e cila, në bazë të vendimeve të Kuvendit Kombëtar, mbajtur në Vlorë, dhe nënshkrimit të Aktit të Pavarësisë, shënon edhe krijimin e shtetit shqiptar.

Kuvendi i Vlorës ishte kurorëzimi i përpjekjeve të vazhdueshme shqiptare për liri, ishte vazhdimi i programit kombëtar të Lidhjes së Prizrenit e kryengritjeve që kishin ngritur në këmbë një popull të tërë, në ato vite të para të shekullit XX.

Përfaqësimi i të gjitha trevave shqiptare në atë Kuvend Kombëtar e po ashtu në Qeverinë e dalë prej tij, pasqyron fare qartë shpirtin e bashkuar kombëtar shqiptar. Mjafton të shfletojmë procesverbalet e shtatë mbledhjeve të Kuvendit të Vlorës, për të parë që aty përfaqësohet gjithë Shqipëria, me trojet e saj në kufijtë e sotëm zyrtar e ato të mbetura padrejtësisht jashtë shtetit amë; mjafton të lexojmë emrat e firmëtarëve të Aktit të Shpalljes së Pavarësisë dhe listën e anëtarëve të Qeverisë së Vlorës, për ta shtuar akoma më tej këtë bindje.

Menjëherë pas Shpalljes së Pavarësisë, Ismail Qemali, në cilësinë e Kryetarit të Qeverisë, i drejtoi Fuqive të Mëdha dhe aleatëve ballkanikë një telegram, me të cilin i njoftonte krijimin e shtetit të ri shqiptar, telegram që u publikua nga shtypi i gjithë Evropës. Duke i kërkuar Fuqive që të njihnin ndryshimin në jetën politike të kombit shqiptar, Ismail Qemali nuk harronte të theksonte se: «Shqiptarët duke hyrë në familjen e popujve të lirë të Evropës Lindore, midis të cilëve krenohen që janë më të vjetrit, kanë vetëm një qëllim, të jetojnë në paqe me të gjithë shtetet e Ballkanit dhe të bëhen një element ekuilibri».

Duke iu referuar këtij telegrami, gazeta prestigjioze italiane «La Stampa», në kolonat e saj bën një koment mjaft kuptimplotë: «Zotit Pashiç -që i ka quajtur shumë herë shqiptarët barbarë- Ismail Qemali i përgjigjet në mënyrë të shkëlqyer, në aktin e parë të qeverisë, duke i thënë se shqiptarët ndjehen krenarë për faktin se janë më të vjetrit në familjen e popujve të Evropës Lindore. Një leksion historie jo i pavend». («La Stampa», Torino, 30 nëntor 1912, f.2) Por dokumenti, ndoshta më i rëndësishëm i Qeverisë së Vlorës, e me një rëndësi akoma më të madhe për historinë e shtetit shqiptar, mbetet Memorandumi që i paraqiti Konferencës së Ambasadorëve të Londrës. Në një gjendje të brendshme mjaft të rënduar, ku ushtritë e aleancës ballkanike, gjoja me pretekstin e luftës ndaj Perandorisë Osmane, po synonin të copëtonin Shqipërinë, ky Memorandum, një kryevepër stili diplomatik në prezantimin e të drejtave shqiptare, dëshmon orientimin thellësisht kombëtar dhe meriton plotësisht mirënjohjen e shqiptarëve brez pas brezi. Dorëzuar në Londër më 2 janar 1912, Memorandumi u botua thuajse tërësisht ditën e nesërmen, nga prestigjiozja londineze «The Times».

Që në rreshtat e parë, Memorandumi i paraqiste Fuqive të Mëdha të drejtat e Shqipërisë për t'u futur në familjen e madhe të Evropës; e njihte me historinë e popullit shqiptar për të ruajtur gjatë shekujve integritetin territorial; e njihte me elementët që i jepnin karakteristikën për të qenë grupi etnik më kompakt në Ballkan dhe i shprehte vendosmërinë e

popullit shqiptar për të qenë një element ekuilibri dhe paqe për Ballkanin etj. Pasi falënderonte Fuqitë e Mëdha për vendimin e tyre që Shqipërisë t'i njihej pavarësia e plotë, Qeveria shqiptare i kërkonte që të ishin sa më të drejtë në vendimin e kufijve, si vendimi bazë për të siguruar paqen në rajonin e Ballkanit. Në Memorandum kërkohet që në shtetin e ri të përfshiheshin, bashkë me rajonet e tyre (përveç Shqipërisë që kemi sot) edhe qytet: Pejë, Mitrovicë, Prishtinë, Shkup, Manastir e deri në Meçovë, për të arritur më pas deri në Prevezë, duke respektuar kufijtë që ekzistonin midis Perandorisë Osmane dhe Greqisë.

Duke shprehur nga njëra anë besimin e plotë në vendimet e Evropës, nga ana tjetër Qeveria shqiptare tërhoqte vëmendjen në një pikë mjaft të rëndësishme, dhe theksonte: «Nëse Evropa do t'i zvogëlojë kufijtë natyrorë të Shqipërisë, nuk bën gjë tjetër vetëm se vendos në rrezik shtetin shqiptar, duke e vënë në pamundësi materiale për të bërë jetën e merituar». Fatkeqësisht, Evropa e njohu të drejtën e popullit shqiptar për të jetuar i lirë e i pavarur, por duke i copëtuar territoret shqiptare me një vendim krejtësisht të padrejtë: Kosova dhe Maqedonia përfundimtare iu dhanë Serbisë dhe Çamëria bashkë me Janinën iu dha Greqisë, pa marrë parasysh që në këto troje popullsia lokale ishte shqiptare në më shumë se 90%.

Kështu, më tepër se gjysma e territorit dhe popullsisë shqiptare mbeti jashtë Shqipërisë. Megjithatë, kushtet për të realizuar ato të drejta legjitime që u nëpërkëmbën më 1913 u dukën sikur u shfaqën përsëri në vitin 1919, në fund të konfliktit të parë botëror, kur të mëdhenjtë u mbledhën përsëri në Paris. «Lipset me çdo mënyrë të fitojmë Kosovën, Manastirin dhe Janinën me gjithë Çamërinë... Lus Zotin ta shikojë pa vdekur Shqipërinë e dashur të lirë, duke pasur në gji të saj të gjitha territoret që ja kanë rrëmbyer» -i shkruante Ismail Qemali më 1918 shqiptarëve të Amerikës, që e kishin zgjedhur përfaqësues të tyre me mandat që «të siguronte dhe garantonte pavarësinë e plotë politike dhe

ekonomike të Shqipërisë dhe të arrinte realizimin e ndryshimeve të nevojshme të kufijve».

I vendosur për të marrë pjesë në Konferencën e Paqes në Paris, që do përcaktonte përfundimisht fatin e Shqipërisë, Ismail Qemali, siç dimë nga letrat e tij, përgatiti një punë mbi origjinën e shqiptarëve, zonën etnografike dhe të drejtat historike e gjeografike të Shqipërisë për t'ia paraqitur si Konferencës ashtu edhe opinionit publik. Por fati e deshi që Ai të vdiste më 24 janar 1919, me ëndrrën e tij të porealizuar dhe fare pak ditë përpara se Konferenca e Paqes të fillonte punimet. Konferenca e Parisit nuk bëri asgjë veçse rinjohu kufijtë shqiptar të '13-ës. Shqipëria mbeti e copëtuar rëndë, por fatmirësisht mbijetoi. Ishte tetor i vitit 1913, kur përpara popullit të Vlorës, pas lajmit që Kosova nuk ishte përfshirë në kufijtë e shtetit shqiptar, Ismail Qemali do shprehej plot largpamësi: «Ne nuk duhet ta humbim shpresën. Kosova është dhe do jetë shqiptare».

Kaluan 95 vjet nga ai tetor kur Kosova, që nuk kishte reshtur së luftuari për lirinë e saj, fitoi pavarësinë. Një dëshmi e dhimbshme e atij gabimi që të mëdhenjtë e Evropës bënë në kurriz të Shqipërisë, në korrik të vitit të mbrapshtë 1913. Një gabim që, në një shekull bashkëjetesë të detyruar, nën sundimin e atyre që gjatë Luftës së Parë Ballkanike kishin si qëllim jo vetëm copëtimin e Shqipërisë, por edhe shfarosjen e shqiptarëve, i kushtoi shumë vuajtje shqiptarëve të Kosovës dhe mijëra jetë njerëzish. Sigurisht sot, në 102 vjetorin e shtetit shqiptar, Ballkani dhe vetë Evropa janë mjaft të ndryshuar, por ne, duke ndjekur gjurmët e të parëve tanë, kemi të drejtën për të besuar që një ditë, mundësisht sa më të afërt, Shqipëria të bëhet siç Zoti e krijoi, e bashkuar në të gjitha trojet e saj dhe pjesë e familjes së Evropës së Bashkuar, në atë Evropë që bën pjesë historikisht, që nga lashtësia.